

**Përmbledhje e të gjeturave nga Raporti i  
Auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2014 të  
Komunës së Ferizajt**



## **Përmbledhje e të gjeturave nga Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2014 të Komunës së Ferizajt**

INPO shpreh shqetësimin e saj sa i përket rezultateve të dalura nga Raporti i Auditimit për Komunën e Ferizajt, ku sipas këtyre rezultateve komuna ka treguar performancë të dobët të menaxhimit të parasë publike si dhe ka bërë shumë shkelje të kërkesave ligjore.

Sa i përket gjetjeve të dalura nga Raporti i Auditimit për vitin 2013, nga 16 rekomandime të cilat i janë ofruar komunës, 3 rekomandime ishin adresuar plotësisht, 10 pjesërisht apo janë në proces të adresimit, dhe 3 nuk ishin adresuar fare. Edhe më shqetësuese është fakti që kjo komunë është zotuar se do të ketë parasysh dhe do të mobilizohet në mënyrë që t'i adresoj këto rekomandime, por përkundrazi Komuna ka qëndruar indiferente dhe me këtë vërtetohet edhe në Raportin e Auditimit të vitit 2014, ku vërejmë se janë përsëritur shkelje të vitit paraprak, e aq më tepër janë shtuar 17 rekomandime të cilat rrjedhin nga 17 shkelje. Të gjitha këto shkelje ligjore janë të ndërlidhura me investimet kapitale ku janë keqpërdorur mjetet financiare të cilat kanë qenë të destinuara për projekte dhe nuk i janë përgjigjur kërkesave ligjore.

Komuna ka bërë një mori shkeljesh e të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me mirëqenien e qytetarëve e që janë të rëndësishme të përmenden:

- A) Keqklasifikim të shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate, duke bërë klasifikimin e shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 201,252 euro.
- B) Gjatë procesit të përgatitjes së pasqyrave, ku në pasqyrat e pasurive jo-financiare të paraqitura në vlerë mbi 1000 euro në PVF ishte në vlerë neto 131,919,340 euro duke mos përfshirë 1,920,554 euro pasuri të blera gjatë vitit 2014.
- C) Komuna ka bërë pagesa të parregullta në vlerë prej 915,833 Euro për donator të ndryshëm për projekte të ndryshme nga kategoria e investimeve kapitale pa ndonjë raport të pranimit të kryerjes së punës.
- D) Sa i përket menaxhimit të brendshëm, komuna është treguar joefikase sa i përket raportimeve nga drejtorët e drejtorive.
- E) Gjatë vitit 2014 komuna nuk kishte të punësuar zyrtar certifikues, ndërsa i gjithë procesi i certifikimit të lëndëve gjatë vitit është bërë nga një certifikues alternativ, i cili këtë funksion e ushtronte si punë të dytë.
- F) Të hyrat e planifikuara nuk arrijnë të realizohen për vet faktin se komuna vazhdon kontratat me qiramarrësit pa i kryer obligimet që kanë ndaj komunës e kjo e shpie komunën në humbje të mëdha financiare.
- G) Vërehet mospërputhje e ngarkesave të faturuara me ato të realizuara, që i bie se është vërtetuar se komuna ka lëshuar fatura pa pranuar të mjete dhe në këtë mënyrë komuna mund të rrezikojë që projektet të cilat janë planifikuar të kryhen nga burimet vetanake të mos arrijnë të realizohen.
- H) Komuna vazhdon të bëjë shkelje edhe sa i përket procedurave të prokurimit duke nënshkruar tri kontrata me kuotim të çmimeve e jo përmes procedurave të hapura të prokurimit, si dhe komuna nuk ka kërkuar raporte të detajuara për kryerjen e punës nga organi mbikqyrës.

Disa prej shkeljeve të tjera të evidentuara në këtë raport janë edhe: Rastet kur komuna vazhdon të bëjë shkelje sistematike në procedurat e prokurimit duke bërë pagesa të projekteve pa perfunduar punimet; Për projektin “Ndërtimi i sallës në shkollën Tefik Çanga” situacioni i katërt përfundimtar në shumën 36,745€ ishte paguar para përfundimit të punimeve në terren. Pagesa ishte bërë duke u bazuar në garancionin për sigurim të avansit; Pagesa në shumën 3,000€ për trajtimin e qenëve endacak ishte ekzekutuar duke u bazuar në kontratën e datës 25.07.2013 (2,600€) dhe kontratës së datës 15.07.2014 (400€). Këto kontrata janë të nënshkruara nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë e jo përmes zyrës së prokurimit; Tek kontrata “Furnizim me lëndë djegëse-thëngjill” për komunën dhe shkollat me vlerë 47,428€ operatori ekonomik fitues nuk e kishte plotësuar kriterin në dosjen e tenderit ku kërkohej që ta ketë veprimtarinë adekuate; Komuna kishte nënshkruar aneks memorandum të mirëkuptimit me Community Development Initiatives (CDI) me datën 18.11.2013 për implementimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Gjithashtu, Kryetari i Komunës ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për renovimin e oborrit të shkollës së mesme “Shaban Hashani”. Në bazë të kësaj marrëveshje komuna ka paguar 17,013€. në muajin gusht nga kategoria investime kapitale. Për marrëveshjet e më poshtme të lidhura në mes Komunës dhe Caritas Kosova, komuna kishte bërë pagesat në llogarinë e Caritas Kosova: Me datën 28.01.2014 kryetari kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Caritas Kosova për projektin “Ngritja e përkujdesit shëndetësor dhe ambulator në Ferizaj” në vlerë prej 250,000€. Po ashtu me datën 10.11.2014 ishte nënshkruar edhe një aneks marrëveshje për projektin e njëjtë ku komuna parashihet të participoj me 150,000€. Me datën 28.01.2014 është nënshkruar edhe marrëveshja për “Ngritjen e përkujdesit në sektorin e edukimit, mbrojtjes shëndetësore për komunitetin RAE (Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptian) si dhe staf profesional” me Caritas Kosova. Me datën 25.03.2013 është nënshkruar marrëveshja bashkëpunimi me Caritas Kosova dhe Kryetarit të Komunës për projektin “Funksionimi i kopshtit të fëmijëve në lagjen e re”. Me datën 25.03.2013 është nënshkruar marrëveshja bashkëpunimi me Caritas Kosova dhe Kryetarit të Komunës për projektin “Funksionimi i kopshtit të fëmijëve në lagjen e re”. Ky projekt parashihet të implementohet nga janari 2014 deri në dhjetor 2017.

Me datën 13.05.2014 është nënshkruar marrëveshja bashkëpunimi me Caritas Kosova dhe Kryetarit të Komunës për projektin “Renovimi i hapësirave në stacionin e autobusëve”. Marrëveshjet e më sipërme nuk ishin në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) neni 4 pika 2 sepse nëse projekti financohet apo subvencionohet 50% ose më shumë nga komuna, komuna do të konsiderohet autoritet kontraktues dhe procedurat e prokurimit duhet të bëhen nga komuna në pajtim me ligjin e prokurimit publik. Komuna nuk i kishte mbikëqyrë realizimin e projekteve të bëra me bashkëfinancim për të vërtetuar nëse parat e shpenzuar të komunës ishin bërë për qëllimin e dhënë.

**Rreziqet:** Siç shihet më lartë, janë bërë pagesa të konsiderueshme nga ana e Komunës. Nuk është e qartë pse komuna iu nënshtrohet kushteve të tilla të marrëveshjes që pagesat të kryhen disa muaj para se të fillon realizimi i projekteve. Nuk është gjithashtu e qartë, pse procedurat e prokurimit nuk zhvillohen nga vet komuna. Kjo situatë përmban një shkallë të lartë të rrezikut që pagesat të kryhen, ndërsa projektet të mos realizohen.

Gjithashtu, rekrutimi i punonjësve pa konkurs zyrtar; Mungesa e monitorimit të subvencioneve nga Komuna; Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren e menaxhimit të pasurive; Hyrje në obligime më shumë se sa buxheti i aprovuar; Mos pagesa e faturave sipas afatit ligjore; Mos adresim i rekomandimeve të NjAB.

Nga të gjitha këto vërejtje të dalura nga raporti i auditimit Komunën e Ferizaj e pasqyrojnë në pozitë të padëshiruar për qytetarët. Në këtë periudhë të vitit Komuna ka bërë keqmenaxhim të parasë duke manipuluar me paranë publike, sa i përket procedurave të prokurimit ku ka kryer pagesa pa u realizuar projekte

Prandaj, INPO i bën thirrje ekzekutivit të Komunës së Ferizaj të mobilizohet dhe të marrë parasysh vërejtjet dhe rekomandimet e dalura nga raporti i auditimit dhe të jap llogari para qytetarëve.

INICIATIVA PËR PROGRES - INPO  
RRUGA "REXHEP LUCI" | PRISHTINË, 10000 KOSOVË  
RRUGA "AHMET KAÇIKU" | FERIZAJ, 70000 KOSOVË  
TEL: +381 (0) 38 220 552 | +381 (0) 290 329 400  
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG